



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik “K.TURJA” shpk & “INFINIT” shpk

Adresa: Bubq Budull, prane Ures se Gjoles, Durres.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rehabilitimi i sheshit përpara degës së Thesarit Tiranë, Rruga “Mustafa Lleshi”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitimi i sheshit përpara degës së Thesarit Tiranë, Rruga “Mustafa Lleshi”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-12256-11-19-2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Fondi limit: 42,278,577 (dyzet e dy milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2021, miratuar me VKB Nr.130, datë 15.10.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.172, datë 21.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021” (e ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës: 5 (pesë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 07.12.2021, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.171 datë 01.12.2021.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk

NUIS K81716011V

Vlera e ofertës = 26,045,592 (njëzet e gjashtë milion e dyzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K.TURJA” shpk & “INFINIT” shpk
NUIS K81314014A & NUIS J74304623M

Vlera e ofertës = **27,457,987** (njëzet e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Glavenica” shpk NUIS K17710805A

Vlera e ofertës = **28,097,257** (njëzet e tetë milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “ZDRAVO” shpk NUIS J84003411K

Vlera e ofertës = **29,126,125.80** (njëzet e nëntë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk NUIS J63229454K

Vlera e ofertës = **29,522,221** (njëzet e nëntë milion e pesëqind e njëzet e dy mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “RSM COMPANY” shpk NUIS L04803001U

Vlera e ofertës = **30,081,891.60** (tridhjetë milion e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = **30,585,468.90** (tridhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “DENIS -05” shpk NUIS K51518029B

Vlera e ofertës = **32,288,213.40** (tridhjetë e dy milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e trembëdhjetë pikë dyzet) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “LEON KONSTRUKSION” shpk NUIS K71820009I

Vlera e ofertës = **33,330,000** (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomik “SIRETA 2F” shpk NUIS K51501008J

Vlera e ofertës = **35,555,555** (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

11. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION shpk & VARAKU-E shpk”
NUIS K81314014A & NUIS J74304623M

Vlera e ofertës = **37,132,159** (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

“Company Riviera 2008” shpk

Referuar VKM Nr.710 date 24.11.2021, Për disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se; *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike”.

KVO, vendosi t'i kërkojë Operatorit ekonomik **“Company Riviera 2008” shpk** dokumentat provuese për vetdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura në rrugë elektronike në SPE brenda të ditës së Enjte datë 23.12.2021 pranë Zyrës së Protokollit, Bashkia Tiranë.

Më date 23.12.2021 operatori ekonomik **“Company Riviera 2008” shpk** me ane të shkresës me Nr.51206 Prot. datë 23.12.2021, ka dorëzuar dokumentacionin provues, të cilin pasi KVO mori në shqyrtim, rezultoi si me poshtë:

- Operatori ekonomik **“Company Riviera 2008” shpk** ka paraqitur dokumentat e njehsuara me origjinalin jo në përputhje me kërkesat ligjore, pasi Vërtetimi i Njesisë me Origjinalin lëshuar nga Noteri nuk përmban të listuar të gjitha dokumentat e njehsuara.
- Për sa më lart, dokumentat e njehsuara me origjinalin të paraqitura nga Operatori ekonomik **“Company Riviera 2008” shpk** bien në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë me Nr.23, date 07.12.2020, ”Për evidentimin, administrimin, ruajtjen e akteve e te dokumenteve noteriale dhe per organizimin, funksionimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale, përfshirë formatin e tyre si dhe formen, përmbajtjen, verifikimin e rregullueshmerise dhe administrimin e regjstrave te veprimtarise noteriale”,

pika 3 ku parashikohet se: *“Dokumenti i vërtetimit të nënshkrimeve, hartohet në mënyrë të veçantë, në numër të njëjtë njësisish sa janë njësitë e dokumentit me nënshkrime të vërtetuara nga noteri, plus një njësi që do të mbahet në arkivin e noterit. Dokumenti i vërtetimit duhet të përmbajë të gjitha elementet e një dokumenti të hartuar nga noteri, duke përshkruar në mënyrë të përgjithshme përmbajtjen dhe llojin e dokumentit, datën e lëshimit të dokumentit, institucionin lëshues dhe nëse ka më tepër se një fletë numrin e fletëve, me nënshkrime të vërtetuara...”;*

Dokumentacioni i dorëzuar nga Operatori ekonomik **“Company Riviera 2008” shpk** është në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit Shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit ku citohet se: “TË GJITHA DOKUMENTET DUHET TË JENË ORIGJINALE OSE KOPJE TË NOTERIZUARA ”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “K.TURJA” shpk & “INFINIT” shpk**, me adresë: *Bubq Budull, prane Ures se*

Gjoles, Durres, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **27,457,987** (njëzet e shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik.